



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KOLONJË

KRYETARI

Projekt - Vendim

NR. ____ DATË. ____ . ____ . 2026

PËR MBËSHTETJEN FINANCIARE PËR ORGANIZIMIN E AKTIVITETIT “FESTA E BIRRËS 2026” DHE PËR SHPËRNDARJEN E FONDEVE BUXHETORE

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar, ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, ligjin nr. 115/2024, “Për buxhetin e vitit 2026, Në vendimin nr.152, datë.22.12.2025, “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Kolonjë për vitin 2026 dhe vendimin e këshillit bashkiak nr.32 datë.20.02.2026”Për rishqyrtim të vendimit nr 27 datë 13.02.2026” “Për miratimin e buxhetit shtesë të Bashkisë Kolonjë për vitin2026”, si dhe kërkesën e Bashkisë Korçë nr. 7987 Prot., datë 30.07.2026, i propozojmë Këshillit Bashkiak në mbledhjen e datës. ____ . ____ . 2026.

1. Të rishpërndarje fondet buxhetore , si mëposhtë vijon:

Pakësim

Gr 00 Titulli 04520 Kap 01 Llog 2313200 Kod Projekti 1200195	në vlerën	700,000 lekë
Gr 00 Titulli 01110 Kap 05 Llog 6090000 Kod Projekti 9999999	në vlerën	300,000 lekë

Totali	në vlerën	1,000,000 lekë
---------------	-----------	-----------------------

Shtesë

Gr 00 Titulli 01110 Kap 01 Llog 6020000 Kod Projekti 9999999	në vlerën	700,000 lekë
Gr 00 Titulli 01110 Kap 05 Llog 6020000 Kod Projekti 9999999	në vlerën	300,000 lekë

Totali	në vlerën	1,000,000 lekë
---------------	-----------	-----------------------

KRYETARI
ERION ISAI

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

N/KRYETAR
PETRO RISTO





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJË

**RELACION
PËR
PROJEKT-VENDIM
NR. ____ DATË. ____ . ____ .2026**

PËR MBËSHTETJEN FINANCIARE PËR ORGANIZIMIN E AKTIVITETIT “FESTA E BIRRËS 2026” DHE PËR SHPËRNDARJEN E FONDEVE BUXHETORE

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar, ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, ligjin nr. 115/2024, “Për buxhetin e vitit 2026, Në vendimin nr.152, datë.22.12.2025, “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Kolonjë për vitin 2026 dhe vendimin e këshillit bashkiak nr.32 datë.20.02.2026”Për rishqyrtim të vendimit nr 27 datë 13.02.2026” “Për miratimin e buxhetit shtesë të Bashkisë Kolonjë për vitin2026”, si dhe kërkesën e Bashkisë Korçë nr. 7987 Prot., datë 30.07.2026,

Administrata i paraqet kryetarit të bashkisë kolonjë **z.Erion Isai** këtë relacion për projektvendimin “Për miratimin e rishpërndarjes së fondeve në buxhetin e Bashkisë Kolonjë dhe dhënien e mbështetjes financiare për organizimin e aktivitetit ‘Festa e Birrës 2026’” përkatësisht në shumën 1,000,000 lek.

Bashkia Korçë i është drejtuar Bashkisë Kolonjë me kërkesë për mbështetje financiare për organizimin e aktivitetit “Festa e Birrës 2026”, aktivitet i cili do të zhvillohet në datat 12–16 gusht 2026. Në kuadër të këtij bashkëpunimi, Bashkia Kolonjë do të promovohet si partner i aktivitetit, përmes spotit promocional, i cili do të transmetohet në 3 ekranet LED në qytetin e Korçës si edhe në skenën e aktivitetit përgjatë 5 netëve të organizimit të aktivitetit "Festa e Birrës 2026"

Organizimi i aktivitetit realizohet nga shoqëria “Media & Production” sh.p.k., partner implementues i përzgjedhur nga Bashkia Korçë, ndaj pagesa e sponsorizimit do të kryhet në emër dhe për llogari të kësaj shoqërie, në llogarinë bankare të saj, sipas dokumentacionit përkatës.

Fondet që do të përdoren për të kryer këtë financim do të meren: vlera 700 000 lekë nga programi buxhetor 04520, projekti "Blerje materiale për ndërtim pacarele" pasi lëndën drusore për ndërtimin e pacarelave e kemi aktualisht gjëndje në magazinë dhe diferenca e mbetur do përdoret për blerjen e materialeve për montimin e tyre. Vlera prej 300 000 lekë do të meret nga fondi rezerve.

Bashkëngjitur këtij relacioni do të gjeni

- Kërkesën e Bashkisë Korçë për mbështetje financiare
- Kontratën e bashkëpunimit midis Bashkisë Korçë dhe Shoqërisë Media &Prodaction Shpk

Duke u nisur nga sa shpjeguam më lart , i propozojmë:

KËSHILLIT TË BASHKISË

1. Të rishpërndarje fondet buxhetore , si mëposhtë vijon:

Pakësim

Gr 00 Titulli 04520 Kap 01 Llog 2313200 Kod Projekti 1200195	në vlerën	700,000 lekë
Gr 00 Titulli 01110 Kap 05 Llog 6090000 Kod Projekti 9999999	në vlerën	300,000 lekë
Totali	në vlerën	1,000,000 lekë

Shtesë

Gr 00 Titulli 01110 Kap 01 Llog 6020000 Kod Projekti 9999999	në vlerën	700,000 lekë
Gr 00 Titulli 01110 Kap 05 Llog 6020000 Kod Projekti 9999999	në vlerën	300,000 lekë
Totali	në vlerën	1,000,000 lekë

Konceptoi: Lorina Diko
Pranoi: Eni Duro



Specialist I D.F.E.B
Drejtori D.F.E.B

Kr. prot. 5021
Dt. 30.7.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

DREJTORIA E TURIZMIT DHE PROJEKTEVE TË ZHVILLIMIT

Dt. 30.07.2026



31.07.2026

Nr. 7984 prot

Lënda: Kërkesë për mbështetje financiare për organizimin e "Festës së Birrës 2026"

BASHKISË KOLONJË

Të nderuar,

Në kuadër të organizimit të "Festës së Birrës 2026", eventit më të madh festiv veror në Shqipëri, i cili do të organizohet te Poli i Jugut, Drenovë, prej datës 12 deri në datën 16 Gusht 2026 synon të promovojë turizmin rajonal, kulturën dhe bizneset e zonës, ju drejtohem me këtë kërkesë për mbështetje financiare të eventit nga Bashkia Kolonjë.

Ky event i rëndësishëm kulturor dhe turistik synon të sjellë së bashku banorët dhe vizitorët në një atmosferë festive, duke ofruar përgjatë 5 netëve një program të veçantë muzikor me performanca live nga artistët më të njohur, promovim të birrave më të njohura e produkteve vendase, duke ndikuar pozitivisht në zhvillimin ekonomik të gjithë rajonit, duke rritur fluksin e vizitorëve dhe duke promovuar atraksionet dhe potencialet turistike të Kolonjës.

Për realizimin me sukses të këtij aktiviteti si edhe për përballimin e një pjese të shpenzimeve që lidhen me organizimin, e aktivitetit "Festa e Birrës 2026", ju paraqesim kërkesën për ofrimin e mbështetjes financiare të Bashkisë Kolonjë në vlerën 1,000,000 (një milion) Lekë.

Jemi të bindur se mbështetja e Bashkisë Kolonjë do të kontribuojë në organizimin e një aktiviteti dinjitoz, i cili do të promovojë vlerat kulturore dhe turistike të territorit dhe do të krijojë një traditë të rëndësishme për komunitetin.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin, mbetemi në pritje të një përgjigjeje pozitive nga institucioni juaj.

KRYETARI I BASHKISË

Sotiraq Filo

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

ZV KRYETARI

Benila Themeli





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË
Qendra e Artit dhe Kultures Korce

QËNDRA E ARTIT DHE KULTURËS

Nr. 29/10 Prot.
Korçë në datë 19 / 04 / 2026

SHOQËRIA MEDIA & PRODUCTION SHPK

Nr. 303 Prot.
Korçë në datë 20 / 04 / 2026

KONTRATË SHËRBIMI
"FESTA E BIRRËS"

Sot, më datë 19 / 04 / 2026, në Korçë lidhet kjo kontratë shërbimi ndërmjet:

QËNDRA E ARTIT DHE KULTURËS KORÇË me adresë Rruga Edit Durham, përfaqësuar nga Drejtore znj. Zamira Beqiraj (Kita) në cilësinë e drejtorit të Institucionit, dhe

SHOQËRISË/MEDIA&PRODUCTION SHPK me nr. NIPT-i M41915019P, me adresë Tirane Rruga "Sadik Petrela" nr.20, përfaqësuar nga Administrator Migena Shehaj, në cilësinë e përfaqësuesit, me tagër dhe kompetencë të plotë për të përfaqësuar shoqërinë në të gjitha marrëdhëniet me Qendrën e Artit dhe Kultures Korçë për realizimin e objektit të kontratës.

Bashkia dhe Subjekti fitues do të referohen në vijim edhe si "Pala" ose "Palët".

Duke qënë se Palët:

Vlerësojnë rëndësinë e promovimit të territorit, përmes aktiviteteve artistike kulturore.

Marrin në konsideratë politikat zhvillimore të Bashkisë Korçë në drejtim të organizimit të aktiviteteve që synojnë organizimin dhe mbështetjen e aktiviteteve artistike kulturore, që favorizojnë rritjen e zhvillimin e jetës kulturore në territorin e Bashkis Korçë nga Qendra e Artit dhe Kultures Korçë.

Synojnë realizimin e objektivave zhvillimore të Bashkisë Korçë, në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile.

Njohin eksperiencën e Qendrës të Artit dhe Kultures Korçë, në organizimin e aktiviteteve artistike kulturore në Korçë dhe jo vetëm.

Konfirmojnë angazhimin institucional për të bashkëpunuar në vijim për organizimin e aktivitetit artistiko kulturor "Festa e Birrës".



Neni 1 Baza Ligjore

- 1.1 Kodi Civil ligji nr.7850, datë 29.07.1994, i ndryshuar;
- 1.2 Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar;
- 1.3 Ligji nr. 8788, datë 07.05.2001 ‘Për organizatat jofitimprurëse’, i ndryshuar;
- 1.4 VKM Nr. 150, datë 3.04.1993, “Për financimin e projekteve kulturore, artistike dhe sportive” (i ndryshuar);
- 1.5 Ligjin nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,
- 1.6 Ligjin nr.68 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” (i ndryshuar),
- 1.7 Ligjin nr.87/2025 “Për buxhetin e vitit 2026”,
- 1.8 Udhëzimin nr. 9 datë 20.03.2018 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar,
- 1.9 Udhëzimin plotësues nr. 2 datë 14.01.2026 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2026”,
- 1.10 Ligjit nr. 10352 datë 18.11.2010 “Për artin dhe kulturën” i ndryshuar,
- 1.11 VKB nr. 139 datë 26.12.2025 “Mbi miratimin e buxhetit vjetor të vitit 2026 dhe PBA 2026-2028 të Bashkisë Korçë”,
- 1.12 Urdhrin nr. 12 datë 07.01.2026 “Për detajimin e shpenzimeve korrente për vitin 2026 të Bashkisë dhe Institucioneve të varësisë sipas programeve dhe produkteve”,
- 1.13 VKB Nr. 99 dt 03.07.2024 “Për miratimin e rregullores së financimit të projekteve kulturore, artistike”
- 1.14 VKB nr. 85 datë 23.05.2022 “Për miratimin e anetareve të Bordit Artistik pranë Q.A.K Korce”
- 1.15 Vendimin nr. 1 datë 10.04.2026 (Nr.26/7 Prot.) të Drejtorit të QAK Zamira Kita (Beqiraj) për shpalljen fitues për organizimin e aktivitetit artistiko kulturor “Festa e Birrës”
- 1.16 Palët së bashku bien dakord të nënshkruajnë këtë Kontratë si më poshtë vijon:

Neni 2 Përkufizime

Termat e përdorura në këtë kontratë, kanë kuptimin e mëposhtëm:

- 2.1 **Kontratë**, nënkupton marrëveshjen e shkruar, e lidhur midis Qendrës të Artit dhe Kulturës dhe Subjektit fitues.
- 2.2 **Palë (ët)**, nënkupton Qendrën e Artit dhe Kulturës dhe Subjektin fitues veç e veç ose të referuar së bashku në këtë kontratë.
- 2.3 **Subjekti fitues**, nënkupton personin fizik/ juridik, i cili do të ofrojë shërbimin sipas përcaktimeve të kësaj kontratë.
- 2.4 **Projekt Propozimi**, nënkupton përshkrimin e detajuar të një serie aktiviteteve, që synojnë zgjidhjen e një problemi të caktuar.
- 2.5 **Buxheti**, nënkupton shprehjen e projektit në vlera monetare.



- 2.6 **Plani i aktivitetit**, nënkupton shtrirjen e aktivitetit në një periudhë të caktuar kohore.
- 2.7 **Raport monitorimi**, nënkupton analizimin e informacionit dhe mbikqyrjen e zbatimit të projektit.
- 2.8 **Raport përfundimtar**, nënkupton përmbledhjen e dinamikës (veprimtaritë/financat) së zbatimit të projektit nga data e nënshkrimit të kontratës deri në datën e realizimit të aktivitetit.

Neni 3

Qëllimi i Kontratës

3.1 Kjo kontratë ka për qëllim rregullimin e marrëdhënieve institucionale midis Qendrës të Artit dhe Kulturës pranë Bashkisë Korçë dhe subjektit Media & Production Shpk, për organizimin dhe zhvillimin e aktivitetit artistiko - kulturor "**Festa e Birrës**".

Neni 4


Të drejtat dhe detyrimet e Qendrës të Artit dhe Kulturës

- 4.1 Qendra e Artit dhe Kulturës ka të drejtën për të mos e kaluar fondin në dispozicion nëse nuk janë përmbushur detyrimet e përcaktuar në kontratë.
- 4.2 Siguron dhe vendos në dispozicion të Subjektit fitues informacionin e nevojshëm për mbarëvajtjen e zbatimit të projektit.
- 4.3 Siguron ambientin e përshtatshme për zhvillimin e aktivitetit.
- 4.4 Në rastet e forcës madhore, Qendra e Artit dhe Kulturës mund të kërkojë në çdo kohë rishikimin ose pezullimin e aktiviteteve të projektit.
- 4.5 QAK, Bashkia Korçë mundëson vendin e organizimit të festës, sigurimin me energji elektrike, ujë dhe staf ndihmës nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike (NSHP), për pastrimin e zonës, asistencë në lidhjen e energjisë elektrike dhe shërbimeve ndihmëse gjatë ditëve të zhvillimit të aktivitetit, si edhe vendosjen në dispozicion të Policisë Bashkiake, për ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike si edhe bllokimin e qarkullimit afër zonës ku do të zhvillohet festa në rast se është e nevojshme.

Neni 5

Të drejtat dhe detyrimet e Subjektit fitues

- 5.1 Zhvillon aktivitetet e përshkruara në **planin e aktiviteteve** dhe **buxhetin** bashkangjitur kësaj kontrate me kujdesin dhe cilësinë e duhur.
- 5.2 Përgatit Raport përfundimtar, ku nënkupton përmbledhjen e dinamikës (narrative dhe financiare) të zbatimit të projektit nga data e nënshkrimit të kontratës deri në datën e realizimit të aktivitetit.
- 5.3 Informon Bashkinë për çdo vështirësi të identifikuar gjatë zbatimit të projektit.



5.4 Subjekti fitues do të sigurojë, përpilojë dhe vë në dispozicion në çdo kohë QAK Korce (Bashkia Korçë) çdo regjistrim ose informacion, me gojë ose me shkrim, që Bashkia mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme në lidhje me zhvillimin e aktiviteteve.

5.5 Siguron pjesëmarrjen e gjerë në aktivitete.

Neni 6 Afati i Kontratës

6.1 Kontrata i shtrin efektet e saj që nga momenti i nënshkrimit deri në datën 16.08.2026.

6.2. Afati për kryerjen e këtij shërbimi është **5 ditë , nga data 12.08.2026-16.08.2026**

6.3 Transporti dhe instalimi i pajisjeve do të bëhet nga kontraktuesi në vendin e përcaktuar nga Bashkia Korçë. Kontraktuesi duhet të ketë përfunduar instalimin e pajisjeve brenda datës 11 Gusht 2026.

6.4. Aktiviteti "Festa e Birres" është parashikuar të zhvillohet në datat 12,13,14,15 dhe 16 gusht.

6.5 Kontraktuesi duhet të heqë pajisjet e instaluara mbas mbarimit të aktivitetit dhe jo më vonë se data 17 gusht 2026.

Neni 7 Prona Intelektuale

7.1 Subjekti fitues duhet të sigurojë Qendrën e Artit dhe Kulturës nga mospërgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose kryerja e Shërbimeve sipas kësaj kontrate.

7.2 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Bashkisë Korçë në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës Subjekti fitues do të marrë përsipër të gjitha përgjegjësitë ligjore që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 8 Vlefë e Kontratës

8.1 Kontrata lidhet për vlerën **12.000.000 (dymbëdhjetë milion)** lekë.

8.2 Kontrata fillon efektet financiare nga data e nënshkrimit të saj.


8.3 Financimi realizohet nga Buxheti i vitit 2026 të Qendrës të Artit dhe Kulturës.

8.4 Vlera financiare e kontratës duhet të depozitohet në llogarinë bankare të Subjektit fitues, të cilat detajet janë si mëposhtë:

Emri i bankës: Union Bank

IBAN: AL36214111060111858437020110

8.5 Qendra e Artit dhe Kulturës do të kryejë likuidimin e vlerës së kontratës, pas realizimit të aktiviteteve të përcaktuara në projekt, përgjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së kësaj marrëveshje nga fondi i parashikuar në buxhetin e vitit 2026 të Qendrës të Artit dhe Kulturës. kaluar me VKB NR. 100 dt. 03.07.2024.



Neni 9

Kushtet e Pagesës

9.1 Pagesa për aktivitetin , do te bëhet brenda 30 diteve nga dita e lëshimit të faturës së fiskalizuar nga subjekti.

9.2 Subjekti në përfundim të aktivitetit, përgatit një relacion mbi zhvillimin e aktivitetit dhe impaktin e tij në publik duke i bashkangjitur dhe foto.

9.3. QAK bën miratimin e pageses vetem në rast se është plotësuar dokumentacioni i mëposhtëm:

- a) Subjekti duhet të lëshojë një fautrë tatimore shërbimi të fiskalizuar për QAK, për shumën që është mbështetur.
- b) Situacionin (duhet të jetë i firmosur dhe i vulosur nga apikuesi, të ketë datë dhe të jetë i rakorduar me faturat për shpenzimet e kryera).
- c) Raport financiar me të gjithë donatorët (situacioni faktik i preventivit total).
- d) Faturat, të cilat duhet të jenë në formën e duhur ligjore referuar legjislacionit tatimor në fuqi.
- e) Kontratat me personat që kanë lëshuar faturat.
- f) Fotokopje e çertifikatës së regjistrimit e subjektit që ka lëshuar faturën.
- g) Fotokopje pashaportë/kartë identiteti.
- h) Vërtetimet nga donatorët, nëse ka.
- i) Relacion mbi zhvillimin e aktivitetit dhe impakti i tij në publik, dhe marrjen në dorëzim të projektit.
- j) 10 foto, si dhe materiale të tjera, dokumentare mbi zhvillimin e aktivitetit.

Dokumentacioni duhet të jetë origjinal.

9.3 Monedha e pagesës do të jetë në Lekë.

9.4 Në zbatim të ligjit nr. 87/2019 "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit", i ndryshuar, fatura e lëshuar nga kontraktuesi duhet të jetë elektronike.

Neni 10



Ndalimi i Nënkontraktimit

Subjekti fitues për zbatimin e projektit për të cilën është shpallur fitues nuk i lejohet të lidhë marrëdhënie nënkontraktuale me një subjekt të tretë.

Neni 11

Gjuha e Kontratës

Gjuha e kontratës është gjuha shqipe.



Neni 12

Vendndodhja e shërbimeve dhe kushtet e lëvrimit

Aktiviteti Festa e Birrës do të zhvillohet në vendin e përcaktuar nga Bashkia Korçe në vijim.

Shërbimet që kërkohen:

Kjo kontratë ka për qëllim organizimin dhe zhvillimin e aktivitetit artistiko - kulturor **"Festa e Birrës"** duke siguruar nga kontraktuesi përmbushjen e gjithë detyrimeve dhe kriteret e veçanta përcaktuara në ftesën për ofertë në kuadër të projektit "Festa e Birrës" që është parashikuar të zhvillohet në datat 12,13,14,15 dhe 16 gusht 2026.

Kontraktuesi duhet të instalojë në vendin e përcaktuar nga Bashkia Korçe aparatet dhe pajisjet e përcaktuara në kriteret e veçanta (specifikimet teknike). Aparatet dhe pajisjet e caktuara në kriteret e veçanta (specifikimet teknike) duhet të jenë funksionale dhe sipas kërkesës.

Subjekti fitues do të përgjigjet për ruajtjen, mirëmbajtjen dhe funksionimin me cilësi të aparateve dhe pajisjeve.


Kontraktuesi duhet të jetë në gadishmeri dhe të përgjigjet në çdo moment gjatë gjithë diteve të zhvillimit të aktivitetit për çdo defekt të krijuar.

Kontraktuesi duhet të ketë përfunduar instalimin e pajisjeve brenda datës 11 Gusht 2026.

Kontraktuesi duhet të heqë pajisjet e instaluar mbas mbarimit të aktivitetit dhe jo më vonë se data 17 gusht 2026.

Kriteret që duhet të plotësohen nga subjekti dhe që nevojiten për organizimin e Festës së Birrës do të jenë si më poshtë:

1. Subjekti/ individ duhet të paraqesë planvendosje për shfrytëzimin maksimal të hapësirës së vënë në dispozicion nga Bashkia.
2. Festa e Birrës duhet të ketë skenë 160 m² dhe lartësi jo më pak se 1,8 metër nga toka.
3. Skena duhet të ketë jo më pak se 120 m² ekran Led outdoor, ku kontraktuesi duhet të sigurojë që të shfaqë grafika shoqëruese sipas programit muzikor për të 5 netët e festës.
4. Të sigurojë foni për të mbuluar një kapacitet jo më pak se 8000 persona, që frekuentojnë festën.
5. Kontraktuesi duhet të marrë përsipër ndriçimin e skenës me robotë dhe efekte speciale shtesë si CO₂ (tymuese skenike).
6. Ndriçimin e të gjithë sheshit të aktivitetit ku do të zhvillohet festa.
7. Vendosjen e 40-60 stendave shërbimi të përshtatshme për bizneset pjesëmarrëse në festë.
8. Të sigurojë jo më pak se 10 (dhjetë) tualeta portative në zonë të dedikuar.
9. Krijimin e zonës me rezervimin, e cila duhet të funksionojë online dhe fizikisht në ambientet e festës.
10. Sigurimin e jo më pak se 300 sete tavolina dhe stola uniforme, (Cdo tavolinë duhet të jetë e pajisur me 2 stola), ku mund të qëndrojnë lirisht 6 persona.



11. Ruajtjen e zonës përgjatë 24 orëve gjatë 5 netëve të festës me staf të kualifikuar të kompanive të sigurisë fizike nga momenti që fillon puna për infrastrukturën e aktivitetit deri në përfundim të tij dhe largimit të gjithë pajisjeve të infrastrukturës së festës, mbulumin me fotograf profesionist, i cili duhet të realizojë video dhe foto gjatë 5 netëve të festës.
12. Krijimin e imazheve digjitale që do të promovohen gjatë festës së birrës, sigurimin e gjithë programit muzikor në të 5-ta netët e festës me jo më pak se 3 këngëtarë dhe/ ose banda muzikore për çdo natë, të cilët duhet të jenë artistë të njohur nga Shqipëria dhe rajoni.
13. Ruajtja dhe shoqërimi i këngëtarëve/ bandave muzikore, para, përgjatë dhe pas performancës së tyre, nga staf i sigurisë i kualifikuar nga kompani të ruajtjes dhe sigurisë fizike.
14. Festa e Birrës duhet të fillojë çdo ditë në orën 20:30 dhe do të vazhdojë deri në orën 1:00 pas mesnate.
15. Hyrja në Festën e Birrës do të jetë e lirë (pa pagesë) në të 5 -ta netët e aktivitetit.
16. Subjekti duhet të koordinojë gjatë gjithë kohës punën me Qendrën e Artit dhe Kulturës dhe Sektorin e Turizmit të Bashkisë Korçë.
17. Logoja e Bashkisë Korçë duhet të jetë logoja qendrore e festës dhe nuk duhet të mungojë në asnjë postim para, gjatë dhe pas festës.
18. Kontraktuesi duhet të sigurojë transportin me mjetet e tij të të gjitha materialeve/ pajisjeve teknike të sipërpërmendura.
- 19.

Neni 13

Përcaktimi i ngjarjeve të forcës madhore

Për efekt të zbatimit të kësaj kontrate, forcë madhore do të quhen:

- a. Fatkeqësitë natyrore, që janë përtej kontrollit të arsyeshëm të palës së prekur, të cilat në mënyrë të arsyeshme nuk mund të priteshin që të ndodhnin; kushtet jashtëzakonisht të këqija të motit, rrufetë, tërmetet, zjarret etj.
- b. Në rastet e forcës madhore, si dhe sipas kërkesës/autorizimit të QAK, subjekti fitues zhvillon aktivitetet sipas kërkesës, në zbatim të vendimeve që dalin për ngjarjet e forcës madhore.


Neni 14

Zgjidhja e Kontratës në rast të forcës madhore

- 14.1 Nëse një ngjarje e forcës madhore vijon apo, Palët mund të vendosin ta zgjidhin këtë Kontratë ose ta vijnë zbatimin e kësaj kontrate, mbi bazën e kushteve të reja të rëna dakord reciprokisht.
- 14.2 Nëse Palët nuk janë në gjendje të arrijnë një marrëveshje në lidhje me këtë, Pala e prekur, do të ketë të drejtën ta zgjidhë këtë kontratë duke lëshuar një njoftim zgjidhjeje.

Neni 15

Njoftimet e Palëve



- 15.1 Çdo komunikim midis palëve do të bëhet me shkrim. Njoftimi i palëve do të bëhet me shkrim brenda 5 ditëve nga marrja dijeni e faktit dhe problemeve që mund të lindin gjatë ekzekutimit të kontratës.
- 15.2 Njoftimet duhet të përmbajnë, por nuk kufizohen, tek të dhënat si më poshtë:
- detajet e duhura në lidhje me shkakun e mospërmbushjes dhe të zgjidhjes;
 - afatin për korrigjimin e ngjarjes së mospërmbushjes si dhe veprimet/masat, që pasojnë mosrespektimin e afatit, sipas përcaktimeve në këtë kontratë;
 - çdo informacion tjetër të rëndësishëm.
- 15.3 Çdo palë duhet të emërojë me shkrim një person ose post organizativ, që do të jetë përgjegjës, në emër të palës, për marrjen e komunikatave dhe për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me ekzekutimin e kontratës.

Neni 16 **Mosmarrëveshjet**

Palët bien dakord që çdo mosmarrëveshje apo kontraditë do të përpiqent'i zgjidhin me mirëkuptim. Nëse palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjes ose konfliktit ato i drejtohen zgjidhjes së kontratës duke respektuar procedurat juridike sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 17 **Rishikimi i Kontratës**

Palët ruajnë të drejtën e rishikimit të Kontratës, në rastet kur QAK e vlerëson të nevojshme të kryhen ndryshime thelbësore në këtë Kontratë.

Neni 18 **Dispozita të fundit**

- 18.1 Pjesë përbërëse dhe e pandarë e kësaj kontrate është plani i aktiviteteve dhe buxheti bashkëngjitur kësaj kontrate.
- 18.2 Kjo kontratë do të quhet e vlefshme duke filluar nga data e nënshkrimit të saj nga palët.
- 18.3 Kjo kontratë u hartua në 3 kopje nga të cilat njërën e merr Subjekti fitues ndërsa 2 të tjerat i mban Qendra e Artit dhe Kulturës, një kopje bëhet pjesë e dosjes ndërsa kopja tjetër qëndron në zyrën e protokollit.

PËR QËNDRËN E ARTIT DHE KULTURËS

DREJTORE

ZAMIRA BEQIRAJ (KITA)



PËR SHOQËRINË

ADMINISTRATORI

